

Vendim nr. 227, datë 03.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Ilir Toska, Anëtar
Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 03.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (Sh) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “ERBIRON”SH.P.K.**, përfaqësuar nga avokati Envi Hicka, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1165, datë 08.05.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-4736, datë 19.12.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i cenimit të së drejtës për gëzimin e qetë të pronës.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar (*ligji për tokën*), komisioni i tokës i fshatit Kashar, me dy akte të vitit 1993, u ka kaluar në pronësi dy banorëve të atij fshati sipërfaqe në dy parcela toke nr. 207 dhe nr. 208. Banorit të parë i janë kaluar sipërfaqet 2500 m² dhe 500 m², ndërsa banorit të dytë sipërfaqja 5000 m². Ndërkohë, komisioni i tokës i fshatit Katund i Ri, me dy aktet e datës 17.05.1996, u ka kaluar në pronësi dy banorëve të tij dy sipërfaqe toke, përkatësisht prej 1500 m² dhe 1375 m².

2. Me vendimin nr. 6, datë 05.06.1996, komisioni i tokës i Komunës Kashar ka përcaktuar kufijtë ndërmjet fshatrave Kashar dhe Katund i Ri, sipas procesverbalit të mbajtur në datën 03.06.1996, duke parashikuar se fshatit Katund i Ri i kalonin vetëm 20000 m² nga parcelat nr. 207 dhe nr. 208. Në vijim, në datën 10.11.1998, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (*ZVRPP*), ka regjistruar pasuritë me nr. 208/1/1 dhe nr. 208/1/2 në emër të dy përfituesve nga aktet e komisionit të tokës të fshatit Katund i Ri. Dy përfituesit i kanë tjetërsuar pasuritë me kontrata shitblerjeje, datë 31.03.2003, në favor të një shtetasi tjetër, i cili, pasi ka regjistruar pronësinë në ZVRPP-në, Tiranë, ia ka kaluar ato me dy kontratat e shitblerjes të datës 11.01.2005 shoqërisë “Erbiron” sh.p.k. (*kërkuesja*). Në datën 25.01.2005 është regjistruar edhe kalimi i së drejtës së pronësisë në emër të kërkueses.

3. Ndërkohë, dy përfituesit nga aktet e komisionit të tokës të fshatit Kashar kanë paraqitur ankesë pranë komisionit të tokës të Komunës Kashar, duke kërkuar verifikimin e vlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi (*AMTP*) të lëshuara në emrin e tyre dhe të atyre të lëshuara në emër të dy përfituesve të fshatit Katund i Ri, me pretendimin se sipërfaqet e tokave mbivendoseshin në parcelën nr. 208. Ankesa është mbështetur në vendimin nr. 230, datë 22.07.1991 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar, sipas të cilit komisioni i tokës i komunës ishte kompetent të shqyrtonte mosmarrëveshjet dhe konfliktet ndërmjet individëve për ndarjen e tokës dhe, në përputhje me dokumentacionin e administruar nga komisioni i fshatit përkatës, të merrte vendimin përkatës.

4. Ankesa është shqyrtuar nga komisioni i tokës i Komunës Kashar, i cili, me vendimin nr. 10, datë 28.09.2005, ka vlerësuar të vlefshme dhe të ligjshme dy AMTP-të e lëshuara në emër të dy banorëve të fshatit Kashar, ndërsa ka konstatuar se dy AMTP-të e lëshuara në emër të dy banorëve të fshatit Katund i Ri nuk ishin në përputhje me ligjin. Ky vendim i është përcjellë për miratim komisionit të tokës të qarkut Tiranë, i cili, me vendimin nr. 2, datë 16.05.2006, e ka miratuar atë dhe ka ngarkuar komisionin e tokës të Komunës Kashar me ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore.

5. Në vijim, dy banorët e fshatit Kashar kanë ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë absolute të dy AMTP-ve të datës 17.05.1996, të lëshuara në emër të dy banorëve të fshatit Katund i Ri, konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave zinxhir të shitblerjes, deri te kalimi i pronësisë në favor të kërkueses (shoqërisë “Erbiron” sh.p.k.), si dhe regjistrimin e pronave në emër të tyre. Me vendimin nr. 6907, datë 16.10.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka rrëzuar padinë. Ajo ka arsyetuar se vendimi nr. 10, datë 28.09.2005 i komisionit të tokës të Komunës Kashar nuk përbënte një akt administrativ përfundimtar dhe të formës së prerë, pasi nuk i kishte dhënë ende zgjidhje përfundimtare mosmarrëveshjes në rrugë administrative dhe, për këtë arsye, nuk mund të shërbente si provë për mbështetjen e padisë. Sipas gjykatës, pas miratimit nga komisioni i tokës i qarkut, çështja duhej t’i rikthehej komisionit të tokës të Komunës Kashar për marrjen e vendimit përfundimtar, gjë që nuk rezultonte të ishte bërë. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar se nuk ishte administruar asnjë provë nga organet e kadastrës që të vërtetonte se parcelat nr. 207 dhe nr. 208, në vitin 1991, i kishin kaluar kooperativës bujqësore Kashar, ndërsa nga provat e administruara rezultonte se deri në vitin 1993 ato ishin në përdorim të ndërmarrjes bujqësore “17 Nëntori”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim dy banorët e fshatit Kashar.

6. Me vendimin nr. 1774, datë 06.11.2008, Gjykata e Apelit Tiranë ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Ajo ka arsyetuar se, megjithëse paditësit, me kërkesën e datës 15.10.2007, kishin kërkuar pushimin e gjykimit, gjykata e shkallës së parë nuk ishte shprehur për këtë kërkim, në kundërshtim me nenin 299, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, çështja duhej t’i kthehej gjykatës së shkallës së parë, si gjykata kompetente për t’u shprehur fillimisht për kërkesën e paditësve për pushimin e gjykimit.

7. Mbi bazën e rekurseve të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 842 (91), datë 18.02.2015, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e ka kthyer çështjen për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkesa procedurale e paditësve për pushimin e gjykimit ishte depozituar në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë, pasi trupi gjykues ishte tërhequr në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë, duke shpallur vendimin pa marrë në shqyrtim këtë kërkesë, kishte vepruar në përputhje me nenet 305 dhe 306 të KPC-së. Gjykata e Lartë ka vlerësuar gjithashtu se, për sa kohë në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë ishte zhvilluar hetimi gjyqësor, palët kishin paraqitur provat dhe kishin debatuar mbi kërkimet e pretendimet e tyre, gjykata e apelit, në zbatim të kompetencave të saj, mund ta shqyrtonte çështjen në themel, duke përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor, nëse e çmonte këtë të nevojshme.

8. Pas rigjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1165, datë 08.05.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka pranuar padinë. Konkretisht, ajo ka vendosur anulimin e AMTP-ve të lëshuara në emër të dy banorëve të fshatit Katund i Ri, konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave zinxhir të shitblerjes deri te kalimi i pronësisë në favor të kërkueses, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, fshirjen e regjistrimit të pasurive në emër të kërkueses dhe regjistrimin e tyre në emër të dy banorëve të fshatit Kashar.

9. Në arsyetimin e saj, gjykata e apelit, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë dhe bazuar në provat e administruara gjatë gjykimit, ka vlerësuar se AMTP-të e kundërshtuara ishin nxjerrë në kapërcim të kompetencave të komisionit të tokës të fshatit Katund i Ri, në kuptim të neneve 116, shkronja “b”, dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative. Sipas saj, ishte provuar se sipërfaqja e tokës e përfshirë në këto AMTP ishte trajtuar që në vitin 1993 nga komisioni i tokës i fshatit Kashar, në zbatim të ligjit për tokën dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Për rrjedhojë, komisioni i tokës i fshatit Katund i Ri nuk kishte kompetencë të dispononte për këto sipërfaqe, të cilat nuk kishin qenë në administrimin e këtij fshati dhe, për më tepër, ishin disponuar më parë nga komisioni i tokës i fshatit Kashar. Sipas gjykatës, kjo e metë themelore e akteve administrative fillestare sillte pavlefshmërinë edhe të veprimeve juridike të mëvonshme për kalimin e pronësisë, përfshirë kontratat e shitblerjes në zinxhir deri te kërkuësja. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuësja.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4736, datë 19.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjërin prej shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka respektuar normat procedurale dhe u ka garantuar palëve ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, duke u dhënë mundësinë të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë mbi to dhe të parashtrojnë qëndrimet e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor. Ajo ka çmuar gjithashtu se gjykata e apelit ka zbatuar drejt dispozitat e ligjit material dhe se vendimi i saj nuk binte në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

11. Në datën 08.05.2026 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 15.05.2026.

II

Pretendimet e kërkueses

12. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

12.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar shkaqet e rekursit që lidheshin me arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe çështjet e ligjit, të cilat duhet të kishin qenë thelbi i vendimmarrjes së saj. Në këtë mënyrë, kërkuesja nuk ka marrë përgjigje për pretendimin se arsyetimi i gjykatës së apelit ishte i pamjaftueshëm, jo logjik dhe arbitrar.

12.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi nr.6, datë 05.06.1996 i komisionit të tokës të Komunës Kashar u ka dhënë efekte prapaveprues përcaktimeve të reja të kufijve, duke cenuar të drejtat civile dhe administrative të përfituara me vendimmarrjet e mëparshme për pronat e dy banorëve të fshatit Katund i Ri.

12.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit nuk ka analizuar çështjet e ngritura në gjykimin në shkallë të parë, të cilat lidheshin me: (i) efektin e vendimit nr. 6, datë 05.06.1996 të komisionit të tokës të Komunës Kashar, në raport me AMTP-të e lëshuara më parë në favor të dy banorëve të

fshatit Katund i Ri; (ii) kompetencën e komisionit të tokës së Komunës Kashar për të ndryshuar kufijtë e tokave që administroheshin nga fshatrat Katund i ri dhe Kashar.

12.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykata e apelit nuk ka kryer një analizë reale të konfliktit juridik mbi pronën, por ka operuar mbi një premisë faktike dhe juridike të paarsyetuar, sipas së cilës një vendim i mëvonshëm administrativ mund të cenojë një të drejtë pronësie të fituar më parë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, individit mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret paraprake të legjitimitetit janë të natyrës kumulative, çka do të thotë se mospërbushja qoftë edhe e njërit prej tyre mjafton që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, vlerësohet përmbushja e një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të rrethanave dhe veçorive të rastit konkret, me synimin që vendimi të jetë sa më i qartë dhe i plotë për kërkuenin. Për rrjedhojë, është e mundur që në këtë fazë të konstatohet mospërbushja edhe e vetëm një kriteri legjitimimi, gjë që sjell moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

15. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit të legjitimitetit *ratione materiae*, i cili lidhet me natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara nga kërkuësja.

16. Në këtë drejtim, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u dëgjuar, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe cenimin e së drejtës së pronës private. Në thelb, ajo ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj lidhur me arsyetimin e pamjaftueshëm, jologjik dhe arbitrar të vendimit të gjykatës së apelit. Konkretisht, sipas saj, kjo e fundit nuk ka analizuar argumentet që lidhen me efektin prapaveprues të vendimit të datës 05.06.1996 të komisionit të tokës të Komunës Kashar në raport me AMTP-të e lëshuara më parë nga komisioni i tokës i fshatit Katund i Ri në favor të të dy banorëve të atij fshati, si dhe me kompetencën e komisionit të tokës të Komunës Kashar për të ndryshuar kufijtë e tokave që administroheshin nga fshatrat Katund i Ri dhe Kashar. Po kështu, ajo ka parashtruar se gjykata e apelit nuk ka kryer një analizë reale të konfliktit juridik mbi pronën, por është mbështetur në premisën se një vendim administrativ i mëvonshëm mund të cenojë një të drejtë pronësie të fituar më parë.

17. Pavarësisht se kërkuesja e ka paraqitur pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës sipas nenit 41 të Kushtetutës, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar, bazuar në parimin *iura novit curia*, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në këtë kuptim, duke iu referuar dhe thelbit të argumenteve të parashtruara, Kolegji çmon se pretendimet e kërkueses duhet të shqyrtohen në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial në gjykatë të lidhur me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Si të tilla, ato, *prima facie*, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës dhe, për këtë arsye, do të analizohen në vijim.

18. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë, si element i së drejtës për proces të rregullt ligjor, përfshin jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për të marrë një përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar për pretendimet e ngritura. Në të njëjtën linjë, ajo ka vlerësuar se e drejta e ankimit duhet të garantohet jo vetëm në aspektin formal, por edhe në atë substancial, në mënyrë që individit të ketë një mundësi reale dhe efektive për të kundërshtuar vendimin gjyqësor (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po kështu, Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve gjyqësore garanton që palët të kuptojnë se pretendimet e tyre janë dëgjuar dhe u mundëson atyre të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtën e ankimit (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u takon vendimeve të mospranimit të rekursit, ajo ka pranuar se Gjykata e Lartë mund të përdorë një arsyetim të kufizuar, për sa kohë që pasqyron në pjesën hyrëse shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i fakteve, interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë, si rregull, kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kontrolli kushtetues kufizohet vetëm në verifikimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtën e procesit të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga dy banorët e fshatit Kashar, të cilët kanë paraqitur padi për pavlefshmërinë e AMTP-ve, mbi bazën e të cilave ishte fituar pronësia që më pas kishte kaluar te kërkuesja nëpërmjet kontratave të shitblerjes, si dhe fshirjen e regjistrimit të pronës në emër të saj. Gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar padinë, duke vlerësuar se aktet administrative (vendimi i komisionit të tokës të Komunës Kashar dhe vendimi i komisionit të tokës në qark për miratimin e tij), mbi të cilat mbështetej padia, nuk kishin marrë formë të prerë dhe nuk provonin zgjidhjen përfundimtare të konfliktit administrativ, si dhe se nuk ishte vërtetuar se parcelat objekt gjykimi kishin kaluar në administrimin e Komunës Kashar në kohën kur ishin lëshuar AMTP-të e kundërshtuara. Mbi ankimin e paditësve çështja është shqyrtuar disa herë nga gjykatat e zakonshme, derisa, pas prishjes së vendimit të parë të gjykatës së apelit nga Gjykata e Lartë për shkaqe procedurale, ajo i është kthyer sërish gjykatës së apelit për rigjykim.

22. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë ka ndryshuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka pranuar padinë. Sipas saj, nga provat e administruara rezultonte se AMTP-të e lëshuara

në vitin 1993 nga komisioni i tokës i fshatit Kashar ishin nxjerrë në përputhje me ligjin, ndërsa AMTP-të e lëshuara në vitin 1996 nga komisioni i tokës i fshatit Katund i Ri ishin nxjerrë jashtë kompetencës territoriale të këtij organi, pasi dispononin mbi toka që i përkisnin administrimit të fshatit Kashar. Për këtë arsye, gjykata i ka konsideruar këto akte absolutisht të pavlefshme dhe ka vlerësuar se ato nuk mund të prodhonin pasoja juridike, duke sjellë, si rrjedhojë, pavlefshmërinë e mëpasshme të kontratave të shitblerjes dhe të regjistrimeve të kryera në favor të kërkuases.

23. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuases, duke vlerësuar se gjykata e apelit kishte respektuar normat procedurale dhe materiale të zbatueshme, se palëve u ishte garantuar ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes dhe se nuk rezultonin shkelje të tilla që të justifikonin cenimin e vendimit të kundërshtuar.

24. Nga sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuases i është garantuar aksesit në të tria shkallët e gjykimit, duke iu krijuar mundësia të parashtojë pretendimet e saj dhe t'i kundërshtojë vendimet e gjykatave më të ulëta përmes mjeteve të parashikuara nga ligji. Në këtë kuadër, kërkuësja ka marrë përgjigje për pretendimet e saj thelbësore nga gjykata e apelit. Në veçanti, përfundimi për pavlefshmërinë e AMTP-ve, me të cilat kërkuësja kishte fituar pronësinë, nuk është mbështetur vetëm në vendimin nr. 6, datë 05.06.1996 të komisionit të tokës së Komunës Kashar ose në njohjen e efektit prapaveprues të këtij vendimi. Gjykata e apelit ka arritur në këtë përfundim mbi bazën e vlerësimit se sipërfaqet objekt mosmarrëveshjeje ishin trajtuar dhe disponuar që në vitin 1993 nga komisioni i tokës i fshatit Kashar dhe se, në kohën e lëshimit të AMTP-ve të datës 17.05.1996, ato nuk bënë pjesë në territorin e administruar nga komisioni i tokës i fshatit Katund i Ri. Për rrjedhojë, edhe nëse do të vihej në diskutim efekti juridik i vendimit të datës 05.06.1996, ky argument nuk do të prekte premisën themelore të arsyetimit të gjykatës së apelit, e cila lidhet me mungesën e kompetencës territoriale të organit që ka lëshuar AMTP-të.

25. Nga ana tjetër, vendimi i gjykatës së apelit pasqyron rrethanat e çështjes, pretendimet e palëve, provat e administruara, faktet e konsideruara të provuara dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur zgjidhja e mosmarrëveshjes. Në këto kushte, kundërshtimet e kërkuases për efektet juridike të akteve administrative, kompetencën territoriale të komisioneve të tokës dhe vlerësimin e dokumentacionit të administruar kanë të bëjnë, në thelb, me mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë interpretuar ligjin dhe kanë vlerësuar provat e çështjes. Kërkuësja nuk ka

evidentuar ndonjë mangësi të dukshme në arsyetim, alogjizëm ose element arbitrariteti të një natyre dhe shkalle të tillë që të ngrejë një çështje kushtetuese.

26. Po kështu, Gjykata e Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, ka listuar shkaqet e ngritura në rekurs dhe ka vlerësuar se ato nuk përmbushnin kriteret ligjore për pranimin e tij, duke respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve të mospranimin të rekursit. Në këto rrethana, vetëm fakti që gjykatat e zakonshme kanë arritur në një përfundim të pafavorshëm për kërkuesen nuk është, në vetvete, i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

27. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.